

UDC: 81



ISSN: 1857-9485 (Print)  
ISSN: 2545-4919 (Online)

# ALBANOLOGJIA

*International Journal of Albanology*





UDC: 81

ISSN: 1857-9485 (Print)  
ISSN: 2545-4919 (Online)



**ALBANOLOGJIA**  
**International Journal of Albanology**

11-12/2019  
ALBANOLOGJIA | Vol. 6 | No.11-12 | pp. 248 | Tetova | 2019



ALBANOLOGJIA

International Journal of Albanology

Editor-in-Chief: Vullnet Ameti

Editors: Salajdin Salihu, Fatmir Sulejmani

Publisher: University of Tetova, Republic of North Macedonia

2018

<b>Editorial Board</b> Arbër Çeliku (North Macedonia) ✓ Victor Friedman (USA) ✓ Ali Aliu (North Macedonia) Shezai Rrokaj (Albania) ✓ Fatmir Sulejmani (North Macedonia) Agron Tufa (Albania) Majlinda Nuhiu (North Macedonia) Alexandre Zoto (France) ✓ Ejup Ajdini (North Macedonia) Shaban Sinani (Albania) Ertugrul Karakus (Turkey) ✓ Etleva Lala (Hungary) ✓ Nurgül Yildiz (Turkey) Mahir Mustafa (Switzerland) ✓ Marengelen Verli (Albania) ✗ Bashkim Lajçi (Kosova) ✓ Mehmet Kraja (Kosova) Adil Olluri (Kosova) Donika Dabishevci (Kosova) Haqif Mulliqi (Kosova)	<b>Editorial Council</b> Emine Shabani (North Macedonia) Luljeta Isaku (North Macedonia) Qerim Dalipi (North Macedonia) Isak Sherifi (North Macedonia) Berton Sulejmani (North Macedonia) Nebi Dervishi (North Macedonia) Florim Ajdini (North Macedonia) Izmit Durmishi (North Macedonia) Kushtrim Ahmeti (North Macedonia) Imer Alili (North Macedonia) Hirijete Ziberi (North Macedonia) Zarije Nuredini (North Macedonia) Dëfrim Saliu (North Macedonia) Alida Emimi (North Macedonia)
---	--

<b>Proofreading:</b> (Albanian) Arbër Çeliku, Fatmir Sulejmani  ISSN 1857 – 9485 (Print) ISSN: 2545-4919 (Online) Published twice a year Account no. 160016005478810 Tax no. 4028004139891 Deponent: Narodna Banka na RM Income Code: 723019 Programme: 43 IBAN: MK07 1007 0100 0066 227 SWIFT: NBRM MK 2X	<b>Technical Editing/Layout:</b> Salajdin Salihu  <b>Printing House:</b> Arberia Design <b>Editorial Office:</b> University of Tetova Tetova, Republic of North Macedonia Ilinden, n.n 1200, Tetova Phone: +389 44 356 500 e-mail: <a href="mailto:seminari@unite.edu.mk">seminari@unite.edu.mk</a> URL: <a href="http://www.unite.edu.mk">www.unite.edu.mk</a>
--	--



## PËRMBAJTJA

ME RASTIN E BOTIMIT TË NUMRIT VIJUES TË REVISTËS "ALBANOLOGJIA" .....	9
FIGURA E SKËNDERBEUT MES HISTORISË DHE LETËRSISË .....	11
Salajdin SALIHU	
SKËNDERBEU, SHPIRTMADHI NË VEPRIM .....	12
Zeqirja REXHEPI	
STRATEGJIA POLITIKE DHE DIPLOMATIKE E SKËNDERBEUT PËR NJË KRYQËZATË KUNDËR SHTETIT OSMAN .....	15
Emine SHABANI	
FIGURA E SKËNDERBEUT TE SHKRIMTARËT E RILINDJES .....	20
Rovena VATA	
FIGURA E SKËNDERBEUT MES HISTORISË DHE LETËRSISË- (TREGIMI: ËNDRRA E SKËNDERBEUT) ME AUTOR GJIKË KUQALI .....	26
Dëfrim SALIU, Shejnaze Ajdini - MURTEZI, Avdi VISOKA	
SKËNDERBEU NË LETËRSINË FRËNGE .....	32
PROMOVIME .....	39
Valter MEMISHA	
FJALORI ETIMOLOGJIK ËSHTË NJË KONTRIBUT PËR HISTORINË E GJUHËS, LEKSIKOGRAFINË SHQIPTARE, BALLKANISTIKËN DHE STUDIMET INDOEUROPIANE .....	41
Anila OMARI	
FJALORI ETIMOLOGJIK I KOLEC TOPALLIT - KURORËZIM I STUDIMEVE TË NJË JETE KUSHTUAR HISTORISË SË SHQIPES .....	44
Begzad BALIU	
PROFESOR KOLEC TOPALLI ISHTE AQ TOKËSOR ME JETËN DHE PO AQ QIELLOR ME VEPRËN .....	50
Berton SULEJMANI	
AKADEMIK KOLEC TOPALLI, NJË PERSONALITET I SHQUAR I SHKENCAVE ALBANOLOGJIKE .....	54

<b>GJUHËSI .....</b>	<b>59</b>
Shezai RROKAJ	
NJËSIMI I ALFABETIT GUR THEMELI PËR NJËSIMIN E GJUHËS DHE TË KOMBIT .....	60
Gani PLLANA, Sadete PLLANA	
PROBLEME TË STANDARDIT NË TERMINOLOGJINË TEKNIKE.....	66
Sadete PLLANA, Gani PLLANA	
VËSHTRIM I ZHVILLIMIT TË FUSHAVE TË DIJES DHE I TERMINOLOGJISË TEKNIKE SHQIPE .....	73
Izmit DURMISHI	
KONTRIBUTI I VOJISLLAV DANÇETOVIQIT PËR PRAPASHTESAT E EMRAVE TË SHQIPES ME KUPTIM ZVOGËLUES .....	79
Imer ALILI	
CA REFLEKTIME GJUHËSORE PËR ECURINË E NATYRSHME TË SHQIPES .....	85
Farketa Dibra - ZEQRIRI	
LEKTYRA SHKOLLORE DHE FUNKSIONI I SAJ .....	96
Shadan RAMADANI	
DIALEKTI SCHWYZERDÜTSCH DHE KARAKTERISTIKAT E TIJ .....	101
<b>LETËRSI .....</b>	<b>107</b>
Jehona Rushidi - REXHEPI	
PROJEKTIMI I PIKËPAMJEVE TË KONICËS NË TEKSTET E TIJ SI INTERTEKST .....	108
Besim MUHADRI	
PERIODIZIMI I LETËRSISË SHQIPTARE SIPAS KONCEPTIT TË AKADEMIK REXHEP QOSJES DHE QËNDRIMI NDAJRIKTHIMI TË TË "PËRJASHTUARVE" NGA LETËRSIA.....	113
Ermira YMERAJ	
ARKETIPI I HEROINËS FEMËRORE TE MIGJENI, KADARE, KONGOLI DHE KOLIQI .....	120
Arlindë KOTORRI	
PROZA TREGIMTARE E KIM MEHMETIT.....	126
Arlind FARIZI	
LETËRSIA DHE TELEFONI .....	130
<b>TEATRI .....</b>	<b>136</b>
Haqif MULLIQI	
TEATRI SI MISION NË EMANCIPIMIN E EMOCIONEVE APO SI FYTYRA E DYTË E FAUSTIT SHQIPTAR .....	138



<b>ETNOKULTURË</b> .....	157
Ermira YMERAJ, Elira SMAKAJ	
FJALA DHE FALJA NË KANUN. FJALËT URTA-SI ÇËSHTJE TË PAREMIOLOGJISË.....	159
Salajdin SALIHI	
LUFTA KUNDËR MONUMENTEVE NË TETOVË GJATË VITEVE 30 TË SHEKULLIT XX .....	165
Erjon PAPAGJONI	
FEJA DHE KOMBI .....	168
Krenar DOLI	
ASPEKTE TË SHPËRFAQJES SË KËNGËS DHE VALLES SË DASMËS GJAKOVARE NË RRJETET SOCIALE .....	177
Besa DOGANI	
NDIKIMET POLITIKE NË KULTIVIMIN E TRASHËGIMISË KULTURORE SHQIPTARE NË MAQEDONINË E VERIUT.....	186
<b>MEDIA</b> .....	189
Afrim A. REXHEPI	
ESTETIKA NË EPOKËN DIGJITALE / PROTONIZMI DHE INTERNETI .....	191
Shpresë MULLIQI	
ROLI I MEDIEVE NË MBULIMIN AKTIVITETEVE ZGJEDHORE TË SUBJEKTEVE POLITIKE SERBE NË MEDIET VENDOR GJATË ZGJEDHJEVE PARLAMENTARE 2014-TË.....	197
Hidajete AZIZI	
RRETH STANDARDIT TË SHQIPES NË MEDIA .....	211
Lulzim ALIU	
SHMANGIA E PËRDORIMIT TË GJUHËS LETRARE SHQIPE NË MEDIAT SHQIPTARE.....	224
Albulena ALIDEMA	
PËRDORIMI I GJUHËS STANDARDE NË MEDIAT AUDIOVIZIVE NË KOSOVË .....	232
Donika BAKIU	
GJUHA E TË RINJVE NË RRJETET SOCIALE .....	239
Zurijeta SALIU	
GABIMET DREJTSHKRIMORE DHE GRAMATIKORE NË DISA PORTALE .....	243



## Farketa Dibra - ZEQIRI

### LEKTYRA SHKOLLORE DHE FUNKSIONI I SAJ

UDC 37.091.212:028]:37.091.3

*Abstrakti:* Në terminologjinë tonë pedagogjike termi lektyrë përdoret me një domethënie specifike, që vërtetohet edhe me përdorimin e emërtimeve të shumta si: lektyrë letrare, lektyrë shkollore, lektyrë shtëpiake, lektyrë e detyrueshme, lektyrë e zgjedhur etj. Me përdorimin e këtyre emërtimeve synohet të bëhet kufizimi dhe distancimi nga veprat e tjera letrare që i lexojnë nxënësit, por të cilat nuk janë të parapara si lektyra shkollore/shtëpiake.

Lektura zë një vend të rëndësishëm në programin mësimor të lëndës së gjuhës amtare, detyrat dhe funksionet që dalin drejtpërsëdrejti nga leximi i saj janë të shumta, por mbi të gjitha ajo synon: ta nxisë nxënësin të punojë në mënyrë të pavarur me librin; të mundet nxënësi në mënyrë të pavarur të sjellë gjykime mbi vlerën ideoartistike të veprës letrare; ta zgjerojë kreativitetin dhe imagjinatën; ta pasurojë fjalorin; të ngjallë dashuri ndaj gjuhës dhe letërsisë; ta përmirësojë kulturën e të shprehurit me gojë dhe me shkrim etj. Paralelisht me këtë duhet theksuar se një ndër rolet dhe funksionet që arrihet të realizohet gjatë leximit dhe interpretimit të saj është ai edukativo-arsimor. Ora e lektyrës duhet t'i udhëzojë dhe aftësojë me sukses nxënësit që të mund të lexojnë, kuptojnë, përfjetojnë, ta gjejnë veten në botën që ndeshin në veprat që lexojnë dhe pozitivisht ta formojnë personalitetin e tyre të ri.

Gjykojmë, se lektura duhet kuptuar dhe përdorur si përmbajtje, mënyrë, mjet, formë, aktivitet dhe kusht për ngritjen e kulturës së leximit të nxënësit në kushte dhe rrethana konkrete pedagogjike në shkollë dhe qëllimisht të vazhduara në kushte dhe rrethana familjare/shtëpi.

*Fjalët kyçe:* lektura, leximi, nxënësi, shkolla, mësuesi

*Abstract:* In our pedagogical terminology the term reading material is used with a specific meaning, confirmed as well by usage of numerous labels such as: literary reading material, school reading material, home reading material, obligatory reading material, optional reading material etc. The usage of these terms aims towards limitation and distancing from other literary works read by students, but which are foreseen as home/school reading materials. Reading materials have an important part in the teaching program of the subject of the mother tongue, exercises and functions arising directly from reading these reading materials are numerous, their main objectives being: to encourage students to work independently with a book; to enable students to have an independent judgment on the artistic value of the literary work; to broaden creativity and imagination; to enrich the vocabulary; to encourage love towards language and literature; to improve the culture of expression in written and spoken form etc. At the same time it needs to be emphasised that one of the roles and functions that are successfully realised during reading and interpretation of reading materials is the educational role. The class dedicated to the reading material should guide and successfully train students to read, understand, feel, find themselves in the world they encounter while reading the literary works and positively form their new personality. We claim that reading materials should be understood and used as content, manner, tool, form, activity and condition for improving the students' reading culture, in actual pedagogical conditions and circumstances at school and purposefully continued at home conditions and circumstances.

*Key words:* reading materials, reading, student, school, teacher

Krahas të shkruarit, të folurit dhe të dëgjuarit, të lexuarit është një aktivitet mjaft i rëndësishëm intelektual dhe edukativ, i cili mundëson realizimin e shumë marrëdhënieve komunikative mes njerëzve. Të lexuarit është proces i rëndësishëm jetësor që çon drejt të kërkuarit të diçkaje, por njëkohësisht paraqet edhe nevojë, dëshirë emocionale të çdo individi. "Shkolla, si institucion përmes së cilës përcillen dhe përvetësohen dijet e shoh të lexuarin si çelësin e sukseseve të çdo individi në të gjitha moshat e edukimit të tij" (Gjokutaj, 2012 :201).

Leximin mund ta shohim në dy këndvështrime: së pari si aftësi që zgjeron njohuritë dhe shprehinë e nxënësve dhe se dyti si aftësi ku nxënësi nxjerr dhe kupton nga leximi dhe procesi i cili e çon nxënësin tek interpretimi. Ndryshe thënë leximi është një veprimtari marrëse ku teksti ofron, ndërsa nxënësi merr informacion, se si kuptohet ky informacion varet nga nxënësi, aftësia e tij, qëndrimi i tij gjuhësor etj.

Edhe përkundër një vlere jashtëzakonisht të madhe që ka leximi, kohëve të fundit gjithnjë e më tepër qarkullojnë zëra jo vetëm nga njerëzit e rëndomtë, por edhe nga studiues, metodistë, analistë, mësues të gjuhës dhe letërsisë shqipe, të cilët shprehin dëshpërimin e tyre duke pohuar se ka humbur vlera dhe rëndësia e librit, kemi krizë leximi, të rinjtë gjithnjë e më pak lexojnë..... e kështu me radhë. Bazuar nga ky fakt, kumtesës së sotme jemi qasur nga këndvështrimi i një mësimdhënësi të gjuhës dhe letërsisë shqipe, duke dashur të nxjerrim në pah funksionin dhe rëndësinë që ka leximi te nxënësit, me konkretisht lektyra shkollore, se pikërisht brenda orës së lektyrës vërehet më qartë se kudo tjetër roli dhe rëndësia edukativo-arsimore që luan ajo te nxënësit. "Nëse i kundrojmë plan-programet e lëndës së gjuhës dhe letërsisë shqipe si për shkollë fillore ashtu edhe për atë të mesme do të shohim se lënda e gjuhës amtare i detyron nxënësit të lexojnë një numër të caktuar veprash letrare të emëtuara si lektyra. Prandaj, jo rastësisht themi se mësimi i lëndës së gjuhës amtare e ka mundësinë më të madhe që ta nxisë nxënësin të lexojë" (Dibra-Zeqiri, 2011 : 10).

"Në terminologjinë tonë pedagogjike termi lektyrë përdoret me një domethënie specifike, që vërtetohet edhe me përdorimin e emërtimeve të shumta si: *lektyrë letrare, lektyrë shkollore, lektyrë shtëpiake, lektyrë e detyrueshme, lektyrë e zgjedhur* etj." (Адамческа, 1994: 17). Me përdorimin e këtyre emërtimeve synohet të bëhet kufizimi dhe distancimi nga veprat e tjera letrare që i lexojnë nxënësit, por të cilat nuk janë të parapara si lektyra shkollore/shtëpiake. Nocioni lektyrë shkollore rrjedh nga latinishtja *lektura*, që në përkthim do të thotë: të lexuarit dhe redaktura gjuhësore e teksteve në dorëshkrim, ndërsa në interpretimin tekstual metodik ka domethënien e leximit shkollor, si i këtuillë është emërtim jo i përshtatshëm dhe kështu siç përdoret është nocion konfuz dhe i hapësirë për diskutim. Kjo ndodh për arsye se termi *lektyrë shkollore* nuk ka përmbajtje të definuar precize, sepse leximi si aktivitet zhvillohet edhe në orët e tjera mësimore. Kjo tregon se theksimi i vendit ku lexon nxënësi nuk është kriter konsekuent ose bazë pedagogjike fillestare për përdorimin e termit *lektyrë shkollore*. Shfrytëzimi i tij barazohet në leximin e orës së lektyrës, përkatësisht në shkollë, e cila si aktivitet jo gjithmonë e ka funksionin që ta afrojë veprën letrare pranë nxënësit/lexuesit. Këtu është aktualizuar edhe pyetja nëse shfrytëzimi i termit lektyrë shkollore nuk e zvogëlon dimensionin metodiko-didaktik dhe domethënien e leximit të lektyrës në shtëpi, sidomos nëse dihet se pikërisht përmbajtja e aktivitetit në shtëpi paraqet bazë për realizimin e orës kushtuar interpretimit të veprës letrare.

Si term më i përshtatshëm, i cili do të ndikojë drejtpërsëdrejti në realizimin e një varg objektivash të mësimin të gjuhës dhe letërsisë shqipe është termi *lektyrë letrare*. Ky term i përgjigjet esencës dhe funksionit pedagogjik që luan në procesin e formimit të kulturës së përgjithshme të leximit dhe të kulturës nga letërsia, që duhet të fitojnë nxënësit e shkollës fillore dhe të mesme. Gjithashtu vlen të

përmendet fakti, se ky emërtim dallohet edhe nga emërtimi literatura shkollore në përgjithësi, dallohet edhe nga ajo e lëndëve të tjera në veçanti, sepse është specifik dhe në funksion të drejtpërdrejtë të mësimit të lëndës së gjuhës amtare. Mbi të gjitha termi *lektyrë* duhet kuptuar si kategori pedagogjike. Për ta përfutur dimensionin e vërtetë pedagogjik ajo duhet të jetë në funksion të detyrave konkrete edukative-arsimore të shkollës dhe të mësimit të gjuhës amtare. Për këtë qëllim, është e domosdoshme që gjatë përcaktimit të përmbytjes së saj, të nisët nga thelbi - nxënësi. Ai është subjekt kryesor, të cilit i është kushtuar lektyra. "Lektyra është vendosur në funksion të zhvillimit të tij të përgjithshëm intelektual dhe emocional. Ajo zhvillohet në kontinuitet kohor didaktik-metodik fillon në klasë, vazhdon në kushte familjare/shtëpi dhe përfundon në klasë. Kjo do të thotë, se për ndërtimin e objektivave edukative të saj janë përgjegjës dhe duhet të përgatiten si arsimtari, ashtu edhe nxënësit" (Rexhepi, 2002 : 40).

Arsimtari duhet të jetë i vetëdijshëm se cila vepër letrare përkon më moshën e nxënësve, cila ka subjektin e vetë, stilin e vetë, vlerat e veta edukativo-arsimore, dinamikën e leximit dhe interpretimit, gjithashtu ka edhe qasje specifike didaktiko-metodike të shtjellimit të saj. Prandaj duhet t'i kushtojë rëndësi përgatitjes dhe motivimit të nxënësve për leximin e kujdesshëm të saj. "Arsimtari është faktor vendimtar që i udhëzon nxënësit për mënyrën e leximit të veprës, kuptohet pasi ta ketë lexuar edhe studiuar vetë ai, përcakton kohën e leximit të veprës, përcjell procesin dhe cilësinë e leximit të veprës dhe në kohë të caktuar në bashkëpunim me nxënësit i qaset shqyrtimit të vlerave të saj artistike dhe edukative" (Brada, 2005 : 450). Pra, nxënësit nën udhëheqjen profesionale të mësimdhënësit të lëndës së gjuhës amtare, duhet të aftësohen që të mund t'i kuptojnë porositë e autorëve dhe ta kuptojnë vizionin e tyre për botën. Sipas mënyrës se si nxënësit do të mund ta konceptojnë botën, në atë mënyrë ata do mund ta kuptojnë, se cili libër e përmbush interesimin dhe kureshtjen e tyre, cili u ndihmon t'i demonstrojnë shprehitë e tyre mjeshtërore të gjuhës dhe stilit të shkrimtarit dhe cili u jep mundësi të formojnë marrëdhënie kritike drejt mënyrës së trajtimit të problemeve jetësore që shkrimtarët i paraqesin në veprën letrare.

- Si rrjedhojë, të lexosh një lektyrë/vepër do të thotë, jo vetëm të ndërtosh një kuptim, por në të njëjtën kohë edhe të rindërtosh kuptimin, atë kuptim që autori ka dashur t'i japë tekstit/veprës së tij. Ndërtimi dhe rindërtimi përbëjnë më tepër se një aktivitet të thjeshtë intelektual, sepse leximi ndryshon në varësi të individit. "Të lexosh atë që është shkruar, mund të bëhet në forma të ndryshme, por të lexosh do të thotë të lexosh edhe atë që nuk është shkruar. Pra, lexuesi, në rastin konkret nxënësi, nuk lexon vetëm atë që është në rreshta, por arrin të lexojë edhe ndërmjet rreshtave, duke sjellë një kuptim, interpretim të vetin për atë që lexon. Por, a është i saktë ky interpretim? Në këtë rast nën drejtimin e mësuesit, nxënësit-lexues mund të përfshihen në dialog apo debat për të nxjerrë interpretimet e vlefshme për veprën e lexuar. Për të arritur këtë, në qendër të mësimit vihet jo më vepra/lektyra apo mësuesi, por lexuesi/nxënës, i cili nxitet të marrë pjesë në bashkëbisedime mbi kuptimet e nxjerra nga vepra e lexuar" (Pepa, 2001 : 22). Pra, mësimdhënësi është boshti kryesor që mban ekuilibrin para dhe gjatë orës së interpretimit të lektyrës, prandaj konstatimi i përgjithshëm në të cilin kemi arritur është se, nxënësit do të lexojnë më shumë:
- nëse profesori e njofton nxënësin me veprat letrare që duhet lexuar në shtëpi;
- nëse profesori i drejton nxënësit në një pikë të caktuar tematike të veprës;
- nëse profesori vazhdimisht ndërton situata nga të cilat nxënësit vijë në përfundim se libri është burimi më i afërt dhe më frytdhënës i diturive;
- nëse profesori shpreh kënaqësi dhe gëzim para shpjegimit të çdo libri;

- nëse profesori me shembuj personal tregon se e adhuron dhe e çmon librin;
- nëse profesori për librin flet me dashuri dhe respekt;
- nëse profesori mundëson prani dhe kontakt të përditshme të nxënësve me librin;
- nëse profesori gjatë bisedave me prindër sugjeron lexim të përditshëm për të gjithë anëtarët e familjes;
- nëse profesori i nxit nxënësit ta blejnë dhe ta duan librin;
- nëse profesori lexon para nxënësve fragmente interesante dhe tërheqëse nga libri;
- nëse profesori lexon detaje nga jeta dhe veprimtaria e shkrimtarit;
- nëse profesori gjithmonë gjen kohë për të biseduar me nxënësit rreth veprës letrare që është në interes të tyre;
- nëse profesori nxit debat mes nxënësve dhe inicion diskutime interesante mbi veprën e lexuar;
- nëse profesori insiston në përkryerjen e teknikës së leximit të nxënësit deri në stadin e leximit estetik;
- nëse profesori arrin që të nxënësit ta zhvillojë aftësinë për t'i ndjekur dhe kuptuar ndodhitë në veprë në mënyrë analitike;
- nëse profesori i aftëson nxënësit që individualisht të formojnë kriteriume për ta vlerësuar veprën letrare;
- nëse profesori organizon situata mësimore prej të cilave do të marrë informacion kthyes për mënyrën e leximit të veprës për secilin nxënësi në veçanti;
- nëse profesori i aftëson nxënësit për lexim hulumtues të veprës letrare.

Gjykojmë se, nëse mësimitdhënësi arrin t'i aftësojë nxënësit që bashkërisht t'i realizojnë detyrat konkrete të lartpërmendura, atëherë mund të flasim për një nivel dhe interesim më të madh të nxënësve për lexim dhe për një përmbushje dhe realizim të shumë funksioneve edukativo-arsimore gjatë orës së interpretimit të lekturës. Jo rastësisht themi se ora e lekturës duhet t'i udhëzojë dhe aftësojë me sukses nxënësit që të mund të lexojnë, kuptojnë, përjetojnë, ta gjejnë veten në botën që ndeshin në veprat që lexojnë dhe pozitivisht ta formojnë personalitetin e tyre të ri. Për ta kuptuar më mirë këtë funksion dhe për të qenë të suksesshëm në këtë drejtim është e rëndësishme që mësuesi ta kuptojë se çfarë ndodh kur nxënësit lexojnë. Nëse mësuesi e kupton mirë këtë çast të rëndësishëm të rritjes intelektuale të çdo individit, kjo do t'i ndihmonte ata të përpunonin e të zbatonin strategji, me të cilat do të kontribuonin në zhvillimin, kultivimin dhe nxitjen e lexuesve në mënyrë që ata të reflektojnë mbi atë çka lexojnë, të mendojnë dhe të mësojnë duke reflektuar mbi të lexuarit dhe procese të tjera që lidhen me të.

Duke pasur parasysh qëllimet dhe objektivat që synon t'i realizojë leximi i lekturës, konstatimi jonë i përgjithshëm në të cilin kemi arritur është, se: lektura është një përmbledhje veprash letrare për lexim të pavarur. Funksionet që arrihen të realizohen gjatë leximit të saj janë të shumta, ndër më të spikatur kemi veçuar, se leximi i lekturave mundëson që:

- ta nxisë nxënësin të punojë në mënyrë të pavarur me librin;
- të mundet nxënësi në mënyrë të pavarur të sjellë gjykime mbi vlerën ideo-artistike të veprës letrare;
- t'i zhvillojë aftësitë psikike të nxënësve, në radhë të parë aftësitë intelektuale dhe emocionale për përjetimin, njohjen dhe interpretimin e vlerave estetike të veprës letrare;
- të ndikojë në kultivimin e shijes estetike të nxënësve;

- ta zgjerojë kreativitetin dhe imagjinatën;
- ta pasurojë fjalorin;
- t'i njoftojë nxënësit me veprat artistike dhe kulturore që kanë vlera të përhershme;
- t'i aftësojë nxënësit që t'u qasen veprave artistike me përjetim, hulumtim kritik;
- t'i aftësojë nxënësit për përdorim të pavarur të burimeve të ndryshme të njohurive dhe të vetedukimit;
- ta përmirësojë kulturën e të shprehurit me gojë dhe me shkrim;
- të ndikojë në zhvillimi e aktivitetit mendore dhe aftësive të punës;
- të ndikojë në zhvillimin e vlerave estetike, etike, gjuhësore-stilistike;
- ta begatojnë botën e tyre emocionale, të menduarit analitik-kritik;
- të zhvillohet prirja, ndjenja dhe kureshtja e nxënësve për simbolikën e shprehjeve poetike dhe t'u dhënë më shumë domethënie shprehjeve dhe fotografive artistike;
- t'i njohin vlerat artistike të letërsisë shqipe dhe vështrimin e saj si pjesë të kulturës kombëtare;
- t'i aftësojë nxënësit për përdorimin e mjeteve gjuhësore si në bisedë ashtu edhe në gjuhën e shkruar dhe ligjërimin libror;
- të ndikojë në njohjen e specifikave të përdorimit të gjuhës së teksteve (në shkencë, publicistikë, administratë) dhe të veprave letrare në veçanti, ku gjuha kryen funksionin e elementit artistik të mirëfilltë;
- të ndikojë në zhvillimin e aftësive, të shkathësive dhe të shprehive për lexim dhe shfrytëzim permanent të letërsisë si ushqim të mendjes dhe të shpirtit të njeriut.

Nga e gjithë kjo që thamë më lart, vijmë në përfundim se lektyra duhet kuptuar dhe përdorur si përmbajtje, mënyrë, mjet, formë, aktivitet dhe kusht për ngritjen e kulturës së leximit të nxënësit, në kushte dhe rrethana konkrete pedagogjike, në shkollë dhe qëllimisht të vazhduar në kushte edhe në rrethana familjare.

Pra, të lexuarit është njëri prej aktiviteteve më të rëndësishme të njeriut bashkëkohor, sepse përmes leximit ai njoftohet me ide të reja, arsimohet dhe zbavitet njëkohësisht, mirëpo pas gjithë këtij buri të madh elektronik, pas gjithë kësaj që kanë shpikur rrjetet sociale është vështirë të kërkohej realizimi në masë të madhe i këtij procesi, por mbetemi me shpresën se libri është burim i vetëm i formimit intelektual të çdo individi dhe mjet i pazëvendësueshëm njohurish.

### **Bibliografia**

- Brada, Riza. 2005. *Metodika e gjuhës shqipe për shkollën fillore, botimi III i plotësuar*, "Dukagjini".
- Dibra-Zeqiri, Farketa. 2011. *Funksionet e lektyrës shkollore në shkollat e mesme të Maqedonisë*, (punim magjistrature në dorëshkrim), Shkup.
- Gjokutaj, Mimoza. 2012. *Didaktika e gjuhës shqipe*, Shblu, Tiranë.
- Pepa, Vjollca. 2001. *Letërsi në shkollë*, Tiranë.
- Rexhepi, Nuhi. 2002. *Letërsia shqipe në tekste shkollore të Kosovës (1945-1990)*, Logos, Prishtinë.
- Снежана, Адамческа. 1994. *Методски прирачник за ученичката лектура (I-IV одделение)* - "Легис", Скопје.

